



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 2-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur me
29. 01. 2014 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini , anëtar
3. Adrian Rashiti, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Enver Bikliqi, anëtar
13. Hajrije Salihu, anëtar
14. Blerim Gashi, anëtar
15. Albulena Gashi, anëtar
16. Florent Hoxha, anëtar
17. Petrit Kelmendi, anëtar
18. Ragip Zejnullahu, anëtar
19. Nazmi Krasniqi, anëtar
20. Enver Kozhani, anëtar
21. Feriz Hasani, anëtar
22. Ali Stublla, anëtar
23. Valbona Shillova, anëtar
24. Burbuqe Ilazi, anëtar
25. Arben Bahtiri, anëtar
26. Edita Gashi, anëtar
27. Naser Bytyqi, anëtar
28. Zoran Çirković, anëtar
29. Xhavit Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
3. Numër i konsideruar i drejtorëve të Drejtorateve
4. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
5. Përfaqësuesit e KFOR-it
6. Bekim Krasniqi, OJQ"YADR"
7. Përfaqësuesit e medijave
8. Naser Bytyqi- përkthyes, shqip-serbisht
9. Haki Avdiu, Operator për zërim dhe inqizim të mbledhjes

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezantojnë 28 anëtarë nga gjithësejt 31 anëtar hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se para se të votohet për rendin e ditës ftoi anëtarin e ri Rizah Bajraktarin që të jep betimin i cili në vazhdim dha betimi duke lexuar deklaratën solemne.

Në vazhdim Kryesuesja pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në rendin e ditës të cilin e keni marrë.

Florent Hoxha, i cili tha se me nenin 61 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale parashifet Nënkyetari i Komunës për Komunitete a dihet mirë se në mbledhjen e parë të këtij Kuvendi Kryetari ka emëruar 2 Nënkyetar kurse tani në rendin e ditës është parapa emërimi edhe një Nënkyetari për Komunitete, andaj propozoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, në bazë të neni 60 të cilin ju e përmendët edhe në mandatin e juaj kan qenë dy Nënkyetar gjithashtu edhe me buxhetin për vitin 2014 keni parapa mjete financiare për këto dy pozicione, andaj kërkesa e juaj për ta heq nga rendi i ditës pikën e 3 është e pa bazë.

Zoran Çirkoviq, propozoj që të plotësohet rendi i ditës ku do të shqyrtohet qështja e qkyqjes se 3 familjeve nga ujësjellësi, a priten të qkyqen edhe të tjerët a në pyetje janë gjithësejt 1.000€ fakturat.

Vlora Limani-Hajnuni, rendi i ditës plotësohet vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe kërkesat e tilla duhet të drejtohen organeve kompetente.

Pastaj Kryesuesja vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për 9 kundër aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e parë inauguruese e KK-së
2. Caktimi i numrit të Komiteteve dhe struktura e tyre
3. Emërimi i Nënkyetarit të Komunës për Komunitete
4. Propozim Vendimi për themelimin e KKSB-së

Para se të kalohet në punë sipas rendit të ditës së aprovuar fjalën e mori Labinot Shahini i cili kërkoi që për mbledhjen e radhës së Kuvendit të paraqitet një raport për gjendjen në arsim të Komunës së Lipjanit.

Florent Hoxha, ne si grup parlamentar i PDK-së shprehim shqetësimin tonë për disa dukuri që po ndodhin tani në Komunë si shembull po e marr Liman Boshnjakun ish shofer i Kryetarit të Komunës dhe pjesëmarrës i 3 luftav e në Kosovë në Maqedoni dhe Preshevë i cili tani është larguar nga puna, andaj kërkojm që mos të bëhen diskriminime në baza partiake ndaj punëtorëve.

Vlora Limani-Hajnuni, këtë qështje e keni ngritë z. Florent edhe në media dhe Kryetari i ka dhënë sqarimet për këtë qështje përmes shtypit, andaj unë nuk kam qka të shtoj.

Arben Bahtiri, kërkoj që për mbledhjen e ardhëshme nga Kryetari aktual dhe Bordi i Drejtorëve të paraqesin një raport për qeverisjen e kaluar për 6 vite.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese e Kuvendit tha se besoj që së shpejti do ta kemi një raport për punën e qeverisjes për 6 vitet e kaluara.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e parë inauguruese e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së parë inauguruese?

Me që askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje apo plotësime, Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për tjerat apstenime

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e parë inauguruese e KK-së

Shtesë: Ekstrakti.

II

Caktimi i numrit të Komiteteve dhe struktura e tyre

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni propozoj që përveq komiteteve obligative si që janë Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete të formohen edhe komitete tjera jo obligative ashtu si që kanë qenë në mandatin e kaluarsi që janë:

1. Komiteti për Shëndetësi
2. Komiteti për Arsim
3. Komiteti për Planifikim dhe Urbanizëm dhe
4. Komiteti për Bujqësi

Në Komitetin për Politikë dhe Financa propozoj që të jenë 11 anëtarë kurse në Komitetet tjera të jenë nga 9 anëtarë.

Pastaj hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim propozimin e Kryesueses për themelimin e komiteteve të lartë cekura.

Florent Hoxha, edhe ne si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë propozim për themelimin e komiteteve të lartë cekura.

Vlora Limani- Hajnuni, Kryesuesja, vuri në votim propozimin për formimin e Komiteteve të lartë cekura dhe numrin e anëtarëve të komiteteve dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave absolute

Aprovoi

Formimin e Komiteteve si që janë:

1. Komiteti për Politikë dhe Financa prej 11 anëtarëve
2. Komiteti për Komunitete 9 anëtarë
3. Komiteti për Shëndetësi 9 anëtarë
4. Komiteti për Arsim 9 anëtarë
5. Komiteti për Urbanizëm 9 anëtarë dhe
6. Komiteti për Bujqësi 9 anëtarë.

Pastaj Kryesuesja tha se me Ligj struktura e anëtarëve të Komiteteve caktohet në bazëtë ulëseve të subjekteve politike në Kuvend dhe sipas kësaj propozoj si vijon:

Në Komitetin për Politikë dhe Financa 3 LDK, që sipas Ligjit e kryeson Kryesuesja e Kuvendit, 3 PDK, 2 IQL, AAK, LDD, 1 AKR, 1 VV dhe 1 nga komunitetet pakicë nga lista GIS.

Në Komitetin për Komunitete, 1 LDK, 1 PDK, 1 PD, 1 Komuniteti serb 1 nga komuniteti ashkali, 1 nga komuniteti turk, 1 nga komuniteti kroat 1 nga komuniteti rom dhe 1 nga komuniteti malazez.

Në Komitetin për Shëndetësi 1 nga IQL, AAK, LDD, 3 PDK, 3 LDK, 1 AKR, 1 PSD.

E kryeson IQL, AAK, LDD.

Në Komitetin për Arsim 3 LDK, 2 PDK, 2 IQL, AAK, LDD, 1 VV, 1 AKR.

E kryeson LDK.

Në Komitetin për Planifikim dhe Urbanizëm, 3 PDK, 2 LDK, 1 IQL, AAK, LDD, 1 VV, 1 PSD, dhe 1 PD.

E kryeson PDK.

Në Komitetin për Bujqësi 1 AKR, 1 IQL, AAK, LDD, 3 LDK, 3 PDK, 1 VV,

E kryeson AKR.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin lidhur me propozimet e lartë cekura.

Floren Hoxha, tha se sipas numrit të ulëseve që kemi në Kuvend PDK-së në Komitetin për Politikë dhe Financa i takojnë 4 anëtarë me që kemi 10 anëtarë në Kuvend, andaj kërkoj nga Kryesuesja që të respektohet çelsi.

Labinot Shahini, unë e lexova materialin që na i shpërnda dhe sipas këtij materiali shifet se shpërndarja në komitete reflekton fuqin e numrit në Kuvend dhe na si grup parlamentar e përkrahmi.

Vlora Limani- Hajnuni, PDK-së sipas ulëseve në Kuvend në KPF i takojnë 3.45%, kurse 3.29%, kurse IQL, 1.92% qka do të thotë që PDK-së i është hjekë për afërsisht një gjysmë anëtarë sikurse edhe LDK-se për shkak të përfshirjes së 1 anëtarë nga komunitetet pakicë. .

Florent Hoxha, e kuptoj përqindjen por kërkoj që nga PDK-ja në KPF, të jenë 4 anëtarë në të kundërtën na nuk do të marrim pjesë në takime e komiteteve që do ti zgjedhni ju në formën si që i keni propozuar.

Pasi diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin për strukturën e Komiteteve ashtu si që janë propozuar më lartë dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për 9 kundër miratoi propozimin për strukturën e komiteteve.

III

Emërimi i Nënkyetarit të Komunës për Komunitete

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja Vlora Limani – Hajnuni i dha fjalën Kryetarit të Komunës Imri Ahmeti i cili në vazhdim tha se në seancën e parë solemne unë kam njoftuar Kuvendin për pozicionet e ekzekutivit dhe tani në këtë seancë të parë punuese shfytëzoj rastin që për Nënkyetar të Komunës për komunitete propozoj Sefer Tasholli.

Pas përfundimit të fjalës së Kryetarit, fjalën e kërkoi Florent Hoxha por Kryesuesja nuk i dha fjalën me arsyetim se nuk ka nevoj për debat për këtë pikë me që Kryetari ka shfrytëzuar të drejtën e vetë ligjore dhe ky është emërim.

Në shenjë paknaqësie për mos dhënjen e fjalës mbledhjen e lëshuan anëtarët e Kuvendit nga radhët e PDK-së.

Pastaj Kryesuesja vuri në votim propozimin e Kryetarit për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për miratoi propozimin e Kryetarit dhe mori këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E NËNKRYETARIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE

I. Sefer Tasholli, nga Gadimja e Ulët , me profesion Inxhinier i diplomuar emërohet Nënkyetar i Komunës për Komunitete të Komunës së Lipjanit.

II. Nënkyetari i emëruar sipas pikës 1 të këtij Vendimi është i emëruar politik.

III. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë.

IV. Me kopje të Vendimit të njoftohet i emëruari, Zyra e Përsoneelit, MAPL, ndërsa një kopje të ruhet në regjistratorin e materialeve të Kuvendit.

Shtesë: Vendimi

IV

Propozim Vendimi për themelimin e KKSB-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Haqif Rustemit përfaqësues i Drejtoratit për Mbrojtje dhe Shpëtim i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me procedurat e propozimit të këtij Vendimi si dhe me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja propozoi që në nenin 1 pika 8 të fshihet fjala komuniteti rom, ashkali dhe egjiptjan dhe të parashihen në Vendim ndaras komuniteti rom dhe ashkali e pastaj të vazhdohet me numrin rendor sipas radhës e gjithashtu prej numrit rendor 20 deri numrin 23 të përfshihet me një përfaqësues nga OJQ-të, medijat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Arben Bahtiri, kërkoi që materiali për mbledhjet e Kuvendit të dërgohet në mënyrë mekanike.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, na materialin e kemi dërguar në formë elektronike me që të gjith tani kan kompjutera.

Enver Bikliqi, po më intereson pse në këtë këshill në mandati e kaluar nuk ka marr pjesë komuniteti kroat.

Haqif Rustemi, unë nuk i di arsyet pse nuk kanë marrë pjesë por tani në këtë këshill kemi përfaqësues të komunitetit kroat por nuk e kemi përfaqësuesin e Kishës katolike.

Pasi diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit për themelimin e KKSB-së me propozimet për ndryshim dhe plotësim të cekura më lart dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota përk miratoi këtë:

VENDIM PËR THEMELIMIN E KKSB NË KOMUNËN E LIPJANIT

I.

Me këtë Vendim themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Lipjanit me këtë përbërje:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i komunës, Kryesues i KKSB-së
2. Imer Kaqara, Komandant i stacionit policor në Lipjan, anëtar
3. Vehbi Gajtani, Bashkësia Islame Lipjan, anëtar,
4. Gjorgje Stefanoviq, Kish Ortodokse, Lipjan, anëtar,
5.Kiksha Katolike, anëtar,
6., komuniteti shqiptar,
7. Dragana Trajkoviq, komuniteti serb, anëtar, Lipjan
8. Alush Bikliqi, komuniteti turk, anëtar, Janjevë
9. Bajram Ademi, komuniteti, Ashkali, anëtar, Konjuh
10. Mustafë Rexhepi, komuniteti Rom, anëtar, Madvec
11. Goleme Petar Franjo Komuniteti kroat, anëtar, Janjevë
12., kryesues i Komitetit për Komunitete, anëtar,
13. Gjyste Dabaj, zyrtare për Barazi Gjinore, anëtare,
14. Rasim Hasani, drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar,
15. Sami Bresa, Kryetari i Këshillit të Prindërve, anëtar
16. Major Isak Demiri, FSK, anëtar,
17. Fehmi Gajtani, KLSP, Janjevë, anëtar,
18. Haqif Rustemi, kryesues i EVSB Lipjan, anëtar,
19. Remzi Mehmeti, drejtor i DMSH, anëtar,
20. Radmilla Simijonoviq, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtarë
21. Fitim Sadiku, nga OJQ, mediat, locale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara, anëtar, Poturovc

II.

Në rast të mungesës së Kryesuesit në ndonjë takim, takimin e kryeson nënkryetari i Komunës me të drejta dhe përgjegjësi të plota ashtu siç i ka Kryesuesi i KKSB-së.

III.

Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e punës e KKSB është përcaktuar me UA e lartëshenuar.

IV.

Mandati i anëtarëve të KKSB është i njëjtë me anëtarët e Kuvendit Komunal.

V.

Për punën e tyre anëtarët e KKSB paguhen nga buxheti i komunës. Kompensimi për anëtarët e KKSB për pjesëmarrje në takime, bëhet me shumën ekuivalente të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kompensimi për pjesëmarrje në takimet e KKSB – së bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të mbajtura Brenda vitit kalendarik.

Vendimi u dërgohet: Të emëruarve, shërbimit të Kuvendit, MAPL, MPB.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 11,⁰⁰

***Ekstraktin e hartoi
Sami Murati***

***Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani- Hajnuni***